



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 18.12.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2999_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2793_11_25** i datës 11.11.2025;
- Ankesa e konsumatorit e datës 08.12.2025.

në seancën e mbajtur më datë 18.12.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **B. P.**, nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2793_11_25 i datës 11.11.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 11.11.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2793_11_25 me të cilin e ka shpallur veten jokompetent në pikëpamje lëndore, për të shqyrtuar dhe vendosur në mënyrë meritore, lidhur me ankesën e konsumatorit B. P., për parashkrim të borxhit, ndaj NQ Termokos.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Arsyetimi për mungesë të kompetencës është i pa justifikuar, sepse çështja ka të bëjë me pasojat e keqpërdorimit të borxhit të parashkruar nga një ofrues i licencuar i shërbimeve publike;
- Vazhdimi i mbajtjes së borxhit të parashkruar përbën presion të ndaluar ndaj konsumatorit;
- Kërkon nga Bordi që ta shfuqizojë vendimin e kontestuar dhe të vendosë drejtësisht në mbrojtje të të drejtave të konsumatorit, ashtu që, konsumatorit t'i largohet nga Kartela çdo borxh i parashkruar.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2025 i ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Vendimi i DMK-së i dt. 11.11.2025, Ankesa e konsumatorit e dt. 08.12.2025, Ankesa adresuar DMK-së e dt. 22.04.2025; Përgjigjen e NQ Termokos me nr. 2514 e dt. 21.11.2024 dhe Kartelën e konsumatorit me shifër 005841, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Nga analizimi i shkresave të përmendura si më lartë, DMK ka gjetur se, konsumatori i referohet institutit të së drejtës materiale – institutit të parashkrimit të borxhit sipas nenit 360 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve si në vijim: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 1.2. kërkesat e radios dhe televizionit për përdorimin e stacionit; 1.3. kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit për përdorimin e telefonit e të separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra; 1.4. kërkesat e parapagimit në botime periodike, duke llogaritur nga kalimi i kohës për të cilën është porositur botimi; 1.5. kërkesat për shërbimet e qasjes në internet, shërbimet për përdorimin e e-mail-it, shërbimet për mirëmbajtjen e “faqes elektronike”, dhe shërbimet e lidhura me qasjen në stacionet e radios dhe televizionit kabllor dhe satelitor që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra; 1.6. kërkesat nga administratorët e blloqeve të apartamenteve për shërbimet dhe kërkesat e tjera që arkëtohen në afate tremujore apo më të shkurtra. 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. 3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”.*

Lidhur me këtë çështje, ZRrE prej vitesh mban qëndrim që, parashkrimi si institut i së drejtës materiale, nuk trajtohet dhe nuk shqyrtohet në procedurë administrative dhe në nivel të organeve administrative, për shkak që, kjo çështje është në kompetencën e gjykatave të rregullta në nivel vendi, si çështje kontestuese e natyrës juridiko – civile dhe atë, duke iu referuar nenit 341 – Rregullat e Përgjithshme, të Ligjit nr. L/07-044, për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si vijon: **“Gjykata (theksi i shtuar) nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë”**. Për më tepër, ky qëndrim i ZRrE-së është rikonfirmuar edhe përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, përmes Aktgjykimit me shenjen ARJ.nr.92/2024, i dt. 26.07.2024, ashtu që, ndër të tjera ka konstatuar se, shqyrtimi dhe vlerësimi i parashkrimit të borxhit, duhet të bëhet nga Gjykata, ashtu siç parashihet me ligj rregullimi i këtij instituti dhe e ka obliguar Gjykatën Themelore që në riprocedurë të vlerësoj çështjen e parashkrimit të borxhit, duke i vlerësuar provat dhe faktet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse, citojmë: *“Ndërsa lidhur me konstatimin e gjykatave të instancave më të ulëta, lidhur me vlerësimin e parashkrimit të borxhit nga e paditura, nga vendimi i organit të paditur, nuk mund të konkludohet që kjo çështje është shqyrtuar apo se ka pasur pretendim lidhur me parashkrimin e borxhit, por edhe sikurse të parashtronte një pretendim të tillë në organin administrative dhe nuk do të kishte marrë përgjigje adekuate, një vlerësim dhe eventualisht një përlllogaritje në këtë drejtim,*



varësisht prej mënyrës së vendosjes gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, **duhet të bëhej nga Gjykata, ashtu si parashihet me ligj rregullimi i këtij instituti**”.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Kartelën e konsumatorit si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- NQ Termokos;
- Konsumatorit **B. P.**, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.